



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI  
I KONKURRENCËS

Nr. 454 Prot.  
Datë 29.08.2007

ENTI RREGULLATOR  
I TELEKOMUNIKACIONEVE

Nr. 150/4 Prot.  
Datë 29.08.2007

### MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Sot, më datë 29.08.2007, në Tiranë, mbështetur në Kodin Civil, neni 79 e në vijim, lidhet ky Memorandum Mirëkuptimi (Memorandumi), midis palëve:

*Autoritetit të Konkurrencës*, organ publik i pavaruar për mbrojtjen e konkurrencës, me seli në adresën Rr. "S. Frashëri", Nr.4, Kati IV, Tiranë, këtu dhe më poshtë i njohur si "Autoriteti", përfaqësuar nga Kryetari, Znj. Lindita MILO (LATI).

dhe

*Entit Rregullator të Telekomunikacioneve*, organ rregullator i pavarur në sektorin e telekomunikacioneve, me seli në adresën Rr. "Myslym Shyri", Nr.43 Tiranë, këtu dhe më poshtë i njohur si "ERT", i përfaqësuar nga Kryetar i Këshillit Drejtues dhe Drejtor Ekzekutiv, Z. Hydajet KOPANI;

të cilat, bashkërisht këtu dhe më poshtë do të njihen si "palët".

### I. DISPOZITA TE PERGJITHSIME

#### Neni I

#### Qëllimi dhe objekti

Memorandumi synon arritjen e mirëkuptimit midis palëve për zbatimin e dispozitave të ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003, "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, në sektorin e rregulluar të telekomunikacioneve.

Objekti është përcaktimi i rregullave procedurale për realizimin e bashkëpunimit midis palëve.

H/K

L 1

## Neni 2

### Baza ligjore

Për lidhjen dhe zbatimin e këtij memorandum, palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore, si më poshtë:

2.1 Ligji Nr.9121, datë 28.7.2003, "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, këtu dhe më poshtë i njohur si "ligji nr.9121", neni 70, pika 3;

2.2 Ligji Nr.8618, datë 14.6.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, këtu dhe më poshtë i njohur si "ligji nr.8618", neni 8, neni 9, germa d), neni 45;

2.3 Ligji Nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", këtu dhe më poshtë i njohur si "ligji nr.8485", neni 1, neni 9, pika 1.

## Neni 3

### Konsiderata paraprake

Duke qenë se:

3.1. Autoriteti, në referencë me nenin 3 të ligjit nr.9121 është struktura e ngarkuar me kontrollin e zbatimit të këtij ligji;

3.2. Autoriteti, për arsye të interesit të përgjithshëm, vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ. Në këto raste Autoriteti bën rekomandimet përkatëse (neni 70, pika 2);

3.3. Autoriteti, për zbatimin e ligjit nr.9121 në sektorët e rregulluar, ka detyrimin ligjor të bashkëpunojë me entet dhe institucionet e tjera rregullatore (neni 70, pika 3);

3.4. Autoriteti, përveç ushtrimit të funksioneve të tjera ligjore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9121 merr masat e nevojshme në rastet e vërtetimit të marrëveshjeve të ndaluara sipas nenit 4 të këtij ligji, abuzimit me pozitën dominuese në treg (neni 9), etj;

3.5. ERT, në referencë me nenin 8 të ligjit nr. 8618 është organi rregullator i telekomunikacioneve, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj si dhe politikat e zhvillimit të sektorit të telekomunikacioneve, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

3.6. ERT, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e tregut të telekomunikacioneve, mban parasysh dispozitat e ligjit nr.9121 për të siguruar konkurrencë të ndershme dhe efektive (neni 70, pika 1);

3.7. ERT, përveç ushtrimit të funksioneve të tjera ligjore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8618:

- (i) kujdeset që konkurrenca ndërmjet operatoreve publikë të telekomunikacioneve dhe/ose ofruesve të shërbimeve të telekomunikacioneve të mbështetet në parimet e transparencës, të mosdiskriminimit dhe të ndershmërisë (neni 9, germa d);

HK

L

2

- (ii) përcakton nëse një operator është organizëm me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT) (neni 17);
- (iii) ndërhyt që marrëveshjet e interkoneksionit të jene në përputhje me parimet e konkurrencës në tregun e telekomunikacioneve (neni 45), etj.

Në këto rrethana, Memorandumi, synon t'u mundësojë palëve:

- a) të koordinojnë ushtrimin e kompetencave të mbivendosura për shkak të juridiksionit të njëkohshëm, siç përshkruhet më poshtë, me qëllim që, ndër të tjera, të parandalohen fenomenet e konkurrencës institucionale;
- b) të bashkëpunojnë në interpretimin e termave të përdorura në legjislacionin material respektiv në lidhje me konkurrencën;
- c) të konsultohen me njëri tjetrin lidhur me përcaktimin e tregjeve përkatës për telekomunikacionet, shkallën e konkurrencës efektive, si dhe ekzistencën e dominancës / fuqisë së ndjeshme në të tilla tregje;
- d) të përcaktojnë rregulla të përkufizuara qarte për çështje të reja që mund të shfaqen;
- e) të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për të zbatuar kompetencat dhe autoritetin përkatës ligjor në sektorin e telekomunikacioneve.

#### Neni 4

##### Juridiksioni i njëkohshëm

4.1 Me *juridiksion të njëkohshëm* në kuptim të kësaj marrëveshje, palët bien dakord të nënkuptojnë ushtrimin e njëkohshëm të të drejtave, ose autoritetit ligjor që disponojnë, për rastet dhe çështjet që u përkasin zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 9121.

4.2 Palët çmojnë se *juridiksioni i njëkohshëm* mund të shfaqet, kryesisht, në rastet që përfshijnë vlerësimin dhe abuzimin e supozuar të pozitës dominante në termat e nenit 8 dhe nenit 9 të ligjit nr.9121, nga një ose disa operatorë publik të telekomunikacioneve ose ofrues të shërbimeve të telekomunikacioneve, të deklaruar OFNT nga ERT.

## II. DISPOZITA PROCEDURIALE

#### Neni 5

##### Procedura e bashkëpunimit

5.1 Për arritjen e bashkëpunimit, palët bien dakord që të zbatojnë rregullat procedurale të vendosura në këtë memorandum.

5.2 Kur ndonjëra palë çmon nevojën e bashkëpunimit për çështje sipas përcaktimeve të parashikuara në dispozitat ligjore referuese dhe në këtë marrëveshje, njofton me

HK

L 3

shkrim palën tjetër. Në rastet e juridiksionit të njëkohshëm, do të kërkojë organizimin e një takimi pune, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

5.3 Njoftimi, do të përmbajë informacion paraprak dhe shpjegime të mjaftueshme sqaruese lidhur me rastin dhe çështjen që do të diskutohet, datën, orën dhe vendin e takimit, si dhe nivelin e propozuar të pjesëmarrjes.

5.4 Pala tjetër, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit do të konfirmojë realizimin e takimit, me të drejtën që të parashtrijë me shkrim nëse ka ndonjë opinion paraprak lidhur me rastin dhe çështjet që do të diskutohen në takim.

5.5 Palët në takim do të diskutojnë çështjet e parashtruara dhe, në përfundim, do të dalin me një deklaratë të përbashkët për përfundimet e arritura dhe mënyrën e veprimit (modus operandi). Në se palët e çmojnë të nevojshme, bëjnë publike përmbajtjen e saj.

5.6. Palët, në raste të konsideruara urgjente, mund të ndryshojnë afatet kohore të përcaktuara më sipër, nëpërmjet paraqitjes së kërkesës me shkrim nga pala e interesuar dhe miratimit të saj nga pala tjetër.

5.7 Kur Autoriteti e çmon të nevojshme ushtrimin e rolit sipas nenit 70, pika 2, të ligjit nr.9121 për dhënien e rekomandimeve përkatëse, në zbatim të frymës dhe parimeve të ligjit nr. 8485, do të njoftojë paraprakisht me shkrim ERT-në për fillimin e procesit. Njëkohësisht, ERT do të furnizojë Autoritetin me informacionin e mundshëm, si dhe mendimin për çështjet që do të trajtohen.

5.8 ERT, do të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Autoritetit nëse, sipas rastit dhe nevojës për ushtrimin e funksioneve të veta ligjore për çështje që lidhen me konkurrencën në sektorin e telekomunikacioneve, do të kërkojë mendimin e tij. Me marrjen e kërkesës, Autoriteti do t'i kthejë ERT-së përgjigje me shkrim, mundësisht brenda afatit të kërkuar, por në çdo rast jo më vonë së 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së kërkesës.

### III. DISPOZITA TË VEÇANTA:

#### Neni 6

#### Përcaktimi i tregut përkatës, përcaktimi i dominancës / deklarimi OFNT

6.1. ERT, për përcaktimin e tregut përkatës, zhvillimin e analizës së tregjeve, si dhe të vlerësimit dhe deklarimit të OFNT-ve, në vijim të procedurës dhe konsultimit publik me palët e interesuara, do të kërkojë edhe opinionin e Autoritetit.

6.2. Autoriteti, brenda afatit të përcaktuar për këtë procedurë, i njofton me shkrim ERT-së mendimin e tij. Në përfundim të procesit të konsultimit publik, ERT vlerëson edhe opinionin e Autoritetit. Kur e çmon të nevojshme, Autoriteti, publikon opinionin e tij, duke njoftuar me shkrim paraprakisht ERT-në.

6.3 Autoriteti, në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë marrëveshje, në të gjitha rastet kur ka për të hetuar sipas ligjit nr.9121 një situatë të abuzimit të pozicionit dominues të subjekteve që ofrojnë shërbime publike të telekomunikacioneve, do të

HK

L



kërkoje, gjithashtu, mendimin e ERT-së për çështje të lidhura me përcaktimin e tregjeve, analizën e tyre dhe gjetjet për fuqinë e ndjeshme në treg.

6.4 ERT, brenda afatit të përcaktuar për këtë procedurë, i njofton me shkrim Autoritetit mendimin e tij. Autoriteti, në trajtimin e mendimeve të shprehura me shkrim nga palët e interesuara, vlerëson edhe mendimin e ERT-së. Kur e çmon të nevojshme, ERT, publikon mendimin e tij duke njoftuar me shkrim paraprakisht Autoritetin.

## Neni 7

### Sigurimi i të dhënave dhe shkëmbimi i informacionit

7.1 ERT, në zbatim të përcaktimit ligjor të parashikuar në nenin 34 të ligjit nr.9121, si dhe në përputhje me hapësirat ligjore të përcaktuara në ligjin nr.8618, do të bashkëpunojë me Autoritetin për sigurimin e të dhënave dhe provave të nevojshme të kërkuar prej tij.

7.2 Palët angazhohen të shkëmbejnë çdo informacion që nuk është i kufizuar ligjërisht dhe që i shërben ushtrimit të funksioneve të tyre.

7.3 Pala që merr informacionin, duhet ta trajtojë informacionin e marrë me të njëjtin nivel konfidencialiteti, siç e ka trajtuar më parë pala tjetër. Për këtë qëllim, pala që ofron informacionin duhet që së bashku me të t'i japë palës marrëse dhe instruksionet se si të trajtohet ky informacion.

7.4 Pala pritëse i përdor të dhënat dhe informacionin e marrë në përputhje me autorizimin specifik të palës që siguron.

## Neni 8

### Afati, hyrja në fuqi dhe ndërprerja e Memorandumit

8.1 Afati i këtij Memorandumi është i pacaktuar dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

8.2 Secila prej palëve, mund të tërhiqet dhe ndërpresë zbatimin e këtij Memorandumi në çdo kohë, duke i dërguar njoftim me shkrim një muaj përpara palës tjetër.

8.3. Ndërprerja e Memorandumit sipas pikës 8.2 nuk do të ketë efekte mbi mënyrën e sjelljes së palëve kundrejt një situatë të caktuar, të marrë në konsideratë para njoftimit me shkrim për ndërprerjen e saj.

## Neni 9

### Dispozita të fundme

9.1 Memorandumi hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e saj nuk është në tejkalim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore të

HK

L 5

parashikuara ne legjislacionin material. mbi të cilin ato mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave.

9.2 Palët, zotohen të zbatojnë rigorozisht Memorandumin për sa parashikohet në të. Gjithsesi, moszbatim nga palët bashkërisht ose në mënyrë të njëanshme i ndonjë dispozite ose tërë Memorandumit, nuk përbën shkak për mosmarrëveshje që palët t'i drejtohen Gjykatës. Palët, do të bëjnë përpjekje që raste të tilla të mos ndodhin, ose të zgjidhen në mirëkuptim. Në rast të kundërt, secila nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Memorandumin, sipas përcaktimit në pikën 8.2.

9.3 Palët, duke rënë dakord paraprakisht midis tyre, mund të ndryshojnë ose shtojnë dispozita në Memorandum.

9.4 Me qëllim lehtësimin dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm për zbatimin e këtij Memorandumi, palët bien dakord që të caktojnë personat dhe mënyrën e kontaktit midis tyre, si më poshtë:

Për Autoritetin: ZIZj: Alda Milo  
Tel. 234 494  
Fax. 234 494  
e-mail: amilo@caa.gov.al

Për ERT: ZIZj: Suzmit Zabaj  
Tel. 259 571  
Fax. 259 106  
e-mail: gzabaj@ert.gov.al

9.5 Memorandumi ka 9 (nëntë) nene dhe mbahet në 2 (dy) origjinalë, nga një për secilën palë.

#### NENSHKRUESIT

Për Autoritetin:

**KRYETAR**  
  
**LINDITA MILO (LATI)**



Për ERT:

**KRYETAR I KESHILLIT DREJTUES**  
  
**HYDAJET KOPANI**

